



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 2 shkurt 2015

Numri i lëndës: 2014-27

Qerim Begolli

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 2 shkurt 2015, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 16 prill 2014.

II. FAKTET

2. Siç janë paraqitur nga ankuesi, faktet e lëndës mund të përmbliohen si në vijim.

3. Më 3 shtator 1990, ankuesi ishte përfshirë dhe dyshohet se ishte lënduar në një aksident trafiku rrugor në Bazel, Zvicër. Ai tani jeton në Prishtinë.
4. Fondi shtetëror zviceran i sigurimit ndaj aksidenteve (SUVA), shoqëri sigurimesh e sektorit publik, nuk kishte pranuar kërkesë e ankuesit për kompensim në një datë të pacaktuar të vitit 1998.
5. Më 29 tetor 2006, ankuesi ka parashtruar një ankesë kundër vendimit të SUVA në Gjykatën e Sigurimeve të kantonit të Cyrihut. Duket se ankesa e tij nuk kishte pasur sukses.
6. Më 15 shkurt 2013, ankuesi ka aplikuar për vizë zvicerane në Ambasadën e Zvicrës në Kosovë, në mënyrë që të kthehet në Zvicër dhe të merr trajtim mjekësor atje. Kërkesa e tij ishte refuzuar më 20 shkurt 2013.

III. ANKESAT

7. Duket se ankuesi kërkon t'i lejohet të kthehet në Zvicër dhe të merr trajtim mjekësor atje.

IV. LIGJI

8. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
9. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
10. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave.
11. Paneli konstaton se ankesa e ankuesit ka të bëjë me një kontest rreth sigurimit me një kompani zvicerane të sigurimit dhe autoriteteve

zvicerane. Gjithashtu duket se kjo ka të bëjë me pamundësinë e ankuesit për të pasur trajtim mjekësor në Zvicër. Nuk është treguar se EULEX-i ka qenë i përfshirë në ndonjë cilësi në këtë çështje.

12. Si pasojë, kjo ankesë bie jashtë kuadrit të mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë dhe si rrjedhojë bie jashtë kompetencës së Panelit, siç saktësohet në rregullin 25 të rregullores së vetë të punës dhe të OPLAN-it të EULEX-it Kosovë (shih *Shaip Gashi kundër EULEX-it*, 2013-20, 2013-20, 26 nëntor 2013, § 9, *Mensur Fezaj kundër EULEX-it*, nr. 2014-20, 26 gusht 2014, §§ 9-10).

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se ankesa është e pabazuar në bazë të nenit 29 (e) të rregullores së vet të punës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

Joanna MARSZALIK
Zyrtare ligjore

Magda MIERZEWSKA
Kryesuese